

VENDIM
Nr. 1, datë 9.5.2012

PËR MIRATIMIN E LOGOS KOMBËTARE TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË, SË BASHKU ME SHKRIMIN “100 VJET PAVARËSI” DHE PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË SAJ

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe të pikës 3 të vendimit nr. 782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komisionit Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive Festive për “Vitin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Komisioni Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive Festive për “Vitin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e logos kombëtare të 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, së bashku me shkrimin “100 Vjet Pavarësi”, sipas modelit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Logoja kombëtare e 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë përdoret në:

- Dekretet e Presidentit;
- Vendimet e Kuvendit;
- Aktet e Këshillit të Ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e Kryeministrit;
- Urdhrat dhe udhëzimet e ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kuvendit;
- Vendimet e institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e rektoratit të universiteteve;
- Dokumentet e krijuara nga autoritetet publike;
- Veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse, kur ato zhvillohen në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë. Për përdorimin e logos organizatat njoftojnë Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Përmasat e logos në një letër format A4 janë: e lartë: 34.5 mm; e gjerë: 36 mm; shkrimi “100 Vjet Pavarësi” vendoset në mes, poshtë flakadani shqiptonjë dhe është 20.5 mm i gjerë e 3.6 mm i lartë. Logoja vendoset gjithmonë lart, djathtas. Ajo qëndron rreth 15 mm larg skajit anësor dhe 15 mm poshtë skajit të sipërm të letres në faqen e parë të aktit ose dokumentit, sipas modelit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Logoja të përdoret në posterat dhe ftesat e veprimtarive të rëndësishme shtetërore dhe ndërshtetërore, që do të zhvillohen në kuadër të 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.

5. Logoja përdoret edhe për prodhimin e një steme të përmasave të vogla, e cila mund të vendoset si distinktiv gjatë ceremonive të ndryshme zyrtare, shtetërore dhe ndërshtetërore.

6. Logoja nuk zëvendëson në asnjë rast stemën e Republikës, por përdoret së bashku me të. Logoja, ashtu si dhe stema e Republikës, vendoset në të gjitha aktet zyrtare të sipërpërmendura gjatë gjithë vitit 2012.

7. Logoja, kur paraqitet e shoqëruar me stema shtetesh të tjera, vendoset në një vend të dukshëm, së bashku me stemën e Republikës ose në të njëjtin vend me to.

8. Logoja të shkarkohet nga faqja elektronike zyrtare e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

9. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT
Sali Berisha